



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGISJË
Sekretaria

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më ____ .06.2023

MBLEDHJA Nr. 33,
Datë 27.06.2023, ora 11:00
e Bordit të ERE-s

Në zbatim të (i) nenit 13 dhe 16, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; i ndryshuar, (ii) nenit 9, të *Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 199, datë 27.11.2020 dhe (iii) nenit 8 dhe 11, të *Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, njoftojmë se **ditën e Martë, datë 27.06.2023, ora 11:00**, do të zhvillohet mbledhja nr. 33 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi miratimin e procesverbalit të mbledhjes së bordit të ERE-s më datë 23.06.2023
2. Mbi përfundimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “SOLE 24 DOOEL SHKUP–Dega në Shqipëri” Degë e Shoqërisë së Huaj, në veprimtarinë e furnizimit dhe të tregtimit të energjisë elektrike dhe njohjen e licencës për ushtrimin e veprimtarisë së furnizimit dhe tregtimit energjisë elektrike, dhënë nga Komisioni Rregullator i Energjisë dhe Shërbimeve të Ujit i Republikës së Maqedonisë së Veriut, për subjektin “SOLE 24 IMPORT-EKSPORT DOOEL SHKUP”
3. Mbi disa ndryshime në vendimin e bordit të ERE-s nr. 63, datë 08.04.2020, “Mbi licencimin e shoqërisë “GEGA-G” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Prevalli” me kapacitet të instaluar 1750 kW” dhe disa ndryshime në vendimin e bordit të ERE-s nr. 64, datë 08.04.2020, “Mbi licencimin e shoqërisë “GEGA-G” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”
4. Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr.188, datë 16.11.2020, “Mbi licencimin e shoqërisë “IDI 2005” shpk në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Kamëçan”, me kapacitet të instaluar 1860 kW”, i ndryshuar
5. Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 249, datë 13.12.2021, i ndryshuar, në lidhje me plotësimin e kushteve të licencimit nga shoqëria “E-VENTO S.R.L ALBANIA” shpk
6. Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 250, datë 13.12.2021, i ndryshuar, në lidhje me plotësimin e kushteve të licencimit nga shoqëria “SOTAL” shpk
7. Mbi miratimin e “Udhëzuesit për testimin e tregut për gazsjellësin Trans Adriatik”

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, në ambientet e ERE-s ose nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik (online), duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën erealb@ere.gov.al, jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe mënyrën e pjesëmarrjes dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

KRYETARI
Petrit AHMETI